



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23.06.2022,  
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: anëtarët e Komitetit: Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Shegë Beqiri, Leutrim Retkoceri dhe Bahri Gashi.

Mungoi: Mirsad Vitia.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Alban Zogaj, nënkryetari i Komunës, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Besianë Musmurati drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Besa Shuleta-Sopjani, zyrtare nga Drejtoria e Financave, Florim Krasniqi, udhëheqës i Sektorit të Planifikimit dhe Osman Bllaca.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Milazim Vitija**, para së të fillonin më diskutimet për pikat e rendit të ditës, tha se tani na erdhi materiali për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucioneve parashkollor në lagjen "Kolovicë e Re", "Mati 1" dhe "Kolovicë e Vjetër".

**Doruntinë Maloku** propozoi në emër të Kryetarit, të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës: **Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu "KOSTT", SH A.**

**Besianë Musmurati** tha se kemi tri propozime prej Drejtorisë së Zhvillimit që të hynë si pika të rendit të ditës:

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucioneve parashkollore në lagjen "Kolovicë e Re", në Prishtinë, në lagjen "Kolovicë e Vjetër" dhe në lagjen "Mati 1" në Prishtinë.**

Me propozimet e dhëna, kryesuesi e hodhi në votim këtë

### REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Informatë mbi qarkoren buxhetore 2023/01;

Faqe 1 nga 9

3. Korniza afatmesme buxhetore 2023-2025( KAB);
  4. Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale;
  5. Propozimvendimi për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës;
  6. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur më Projektregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve më taksë;
  7. Informatë lidhur më mbjelljet pranverore në Kryeqytet;
  8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në lagjen "Kolovicë e Re", në Prishtinë;
  9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në lagjen "Mati 1" në Prishtinë;
  10. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në lagjen "Kolovicë e Vjetër", në Prishtinë;
  11. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu "KOSTT", SH A;
  12. Të ndryshme.
- Kryesuesi konstatoi se u miratua ky rend dite.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Komitetit për Politikë e Financa.

#### Pika e dytë

**Informatë mbi qarkoren buxhetore 2023/01.**

Besa Shuleta-Sopjani tha se qarkorja buxhetore është publikuar gjatë muajit qershor dhe është publike, janë ndarë mjetet, buxhet ka me pas Komuna e Prishtinës 105,495,98.00 euro, si grand i përgjithshëm është 26 milion euro, grand specifik i arsimit është 22 milion euro, i shëndetësisë 7 milion euro dhe Ligji për Kryeqytetin është 15 milion euro.

Të hyra vetanake janë parapare 34 milion euro, ndërsa qarkorja e dytë buxhetore do të del në korrik ose në gushtë varësisht prej Ministrisë së Financave ku përcaktohen saktësisht kufijtë buxhetor.

Donjeta Dragusha tha se qarkorja buxhetore është një dokumente shumë i rëndësishëm nga Drejtoria e Financave që na ndihmon me i përcaktuar kufijtë fillestar të buxhetit. Në këtë qarkore kam vërejtur që specifikohet me pas kujdes në zbatimin e Udhëzimit administrativ për



klasifikimin e projekteve kapitale pasi që e kam parë edhe në raportin e auditimit nga DKA- ja. Komuna e Prishtinës vitin e kaluar ka pasur vërejtje për keq klasifikimin e shpenzimeve për projekte kapitale ku disa shpenzime të projekteve kapitale janë shfrytëzuar si shpenzime të mallrave dhe shërbimeve andaj tash e tutje të kemi kujdes ta zbatojmë këtë udhëzim administrativ.

**Leutrim Retkoceri** tha se sa i përket qarkores buxhetore jam i interesuar me ditë se Komuna dhe drejtoria a i ka dërguar vërejtjet dhe sugjerimet në bazë të qarkores që i ka pranuar edhe kufijtë në mënyrë që të i japin hapësirë në qarkoren e dytë të ketë një konsideratë më të lartë sidomos në tavanet në bazë të qarkores që i ka pranuar edhe kufijtë.

Gjithashtu kam edhe një pyetje deri tash nuk kemi vërejtur zyrtarisht që është dhënë dritë e gjelbër të për ndryshimin e buxhetit të vitit 2022, a keni marrë ndonjë përgjigje dhe nëse po kishte qenë mirë me na dhënë informata.

**Alban Zogaj nënkryetari** dha sqarime lidhur me pyetjet, keni të drejtë plotësisht në atë që thoni kemi pasur vërejtje në qarkoren buxhetore dhe në ndarjen, kemi dërguar disa komente tona dhe kemi kërkuar gjithashtu edhe rishikim të buxhetit i cili me gjasë nuk do të ndodhë as ketë vit, nuk do të kemi rishikim të buxhetit 2022. Jemi në fund të qershorit dhe me gjasë do të vazhdojmë deri në fund me buxhetin i cili është miratuar për vitin 2022 dhe pritet shumë shpejt më filluar në projekt më buxhetin e vitit 2023.

**Kryesuesi** konstatoi së u miratua informata mbi qarkoren buxhetore 2023/01 dhe dërgohet në Kuvend.

**Pika e tretë**

**Korniza afatmesme buxhetore 2023-2025( KAB)**

**Besa Shuleta-Sopjani** dha sqarime lidhur me këtë pikë duke thënë se janë bërë disa ndryshime të vogla, nuk janë ndryshime të mëdha vetëm të emërtimi i projektit ka qenë një gabim i yni që e kemi lëshuar.

**Gëzim Sveçla** tha se të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tona do të i parashtrijmë në seancën e Kuvendit Komunal të Prishtinës.

**Donjeta Dragusha** tha se në kornizën afatmesme buxhetore si grup e përkrahim, atë që e kam vërejtje që është cekur edhe në KAB së është shumë e rëndësishme që deri në qarkoren e dytë buxhetore të kemi një zgjidhje për OSHP-në, në mënyrë që ta dimë saktë se projektet aktuale kanë më u bartë prapë apo kanë më u realizuar në vitin 2022. Po ashtu përveç këtyre projekteve që janë paraqit edhe përfshirë në buxhet, Kryetari Rama ka paraqit në KAB, edhe projekte tjera të mëdha që do të financohen përmes institucioneve ose bashkëpunimit më institucionet tjera.



**Leutrim Retkoceri** tha se vlen mu cekë që KAB-i, po vjen mbas katër viteve, zakonisht KAB-i, ka ardhur më buxhet në shtator unë po shpresoj janë përfillur të gjithë hapat në mënyrë që planifikimi dhe projektet në KAB të jenë të qëndrueshme. Duke i pasur parasysh problemet që i kemi tani që është rritja e çmimeve, një krizë ekonomike që nuk e kemi pasur deri tani dhe normal zhbllokimi i OSHP-së, ishte dashur të paktën për vitin 2023 me u paraparë për ndryshe mundën me u bartë projektet prej këtij viti në atë vite siç na janë bartë vit mbas viti nja 4 vite.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua korniza afatmesme buxhetore 2023-2025(KAB) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e katërt**

**Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale.**

**Besa Shuleta-Sopjani** tha se totali i rezervave është 4 milion e 60 mijë euro, janë projekte të ndryshme, të drejtorive të ndryshme të cilat barten nëse e votoni ju asamblistët, janë dy projekte "Ndërtimi i rrugës A", kolektori ku ka me i pasur 3 milion e 150 mijë euro, prej të hyrave vetanake dhe 350 mijë euro, prej Fondit Qeveritar dhe projekti blerja e skuterëve dhe biçikletave, ka me i pasur 560 mijë euro.

**Gëzim Sveçla** kërkoi informacione më shumë për blerjen e skuterëve.

**Alban Zogaj** nënkryetari tha se në bazë të disa analizave që janë bërë në kabinet kemi paraparë dhe planifikua që më një pjesë të rezervave të blejmë biçikleta publike si fillim si projekt model, pilot i cili i teston së sa do të e përdorin qytetarët biçikletën publike në qytetin e Prishtinës, çfarë rezultati do të jetë e pastaj më e shtri këtë projekt në vitet e ardhshme pra do të blejmë biçikleta të cilat jepen falas dhe që përdoren në të gjitha qytetet e mëdha botërore aty thuhet skuter por jemi të orientuar në biçikleta publike.

**Gëzim Sveçla** tha se a mundemi me përmirësuar këtu vetëm blerja e biçikleta .

**Alban Zogaj**, nënkryetar tha se po të jetë biçikleta publike të cilat janë speciale dhe janë të shtrenjta me këtë shumë nuk mundem mu blerë shumë biçikleta por mendojmë janë të mjaftueshëm me filluar si pilot me pa çfarë efekti do të jetë në teren.

**Gëzim Sveçla** pyeti a ka ndonjë projekt që është i gatshëm për pjesën e shfrytëzimit të biçikletave publike.

**Alban Zogaj**, nënkryetar tha se ka një projekt propozim, kemi marrë përvojat e Tiranës, Shkupit e qyteteve për rreth mundemi me i prezantuar në mbledhje, por kjo është vetëm për me shikuar se ne projektin kemi me e prezantuar ma vonë. Një projekt që ne veq dëshirojmë me filluar e që është ndërtimi i rrugës "A", dhe blerja e biçikletave për qytetarët e Prishtinës.

**Nora Kelmendi** tha se ju 4 milion që po i dërgoni në rrugën "A" dhe biçikleta, e ky 3 milioni e gjysmë e ky 4 milionëshi që figuron te rruga "A" të investimet kapitale a është ky 4 milionësh apo janë tjera ekstra .

**Besa Shuleta Sopjani** tha se këtij 4 milionëshit i shtohen edhe 3 milion e gjysmë euro.



**Bahri Gashi** tha se çështja e rrugës "A" është një punë ma e mençura e kabinetit të juaj, kjo vlera a është vetëm për 1kilometrin në anën e majtë e djathte apo kilometrishin tjetër që është 2 km apo për krejt rrugën.

**Alban Zogaj**, nënkryetar tha se për rrugën "A" tenderi del në javën e ardhshme vetëm për 1 km e gjysmë.

**Bahri Gashi** tha se praktikrat që i përmende të Tiranës, Shkupit dallon gjeografikisht 70% me Prishtinën. Praktika e Prishtinës është kodra, 6 muaj është ftoftë, shi, borë, ndërsa 6 muaj mundë të përdoret biçikleta, skuterë ky është vetëm për 6 mujor po flasim. Sa keni menduar që qytetari i Prishtinës ka me ardhur në punë me biçikleta ose me trotinet se ka rëndësi, kur flasim për këto biçikleta dhe trotinete me u përdor si mjet i punës e jo si rekreacion e me bllokuar qytetin për rekreacion.

**Alban Zogaj** nënkryetar lidhur me këtë tha se është në hartim e sipër një draft i rregullores për shfrytëzimin e skuterëve elektrik, ku kanë marrë praktika edhe të Vjenës dhe të qyteteve tjera botërore, duhet me e rregullua sikurse mjetet tjera të komunikacionit, kështu në mbledhjen e ardhshme do e kemi rregulloren e skuterëve dhe do ta iniciojmë për diskutim publik, pra do ta testojmë, do të bëjmë një pilot projekt do të shohim si do të funksionon ky projekt, mendoj që është projekt i rëndësishëm për qytetarët e Prishtinës.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e pestë**  
**Propozimvendimi për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës**

**Besianë Musmurati**, drejtoresha tha se është një ndryshim që një anëtare e komisionit nga DKA-ja që ka qenë Ardiana do të zëvendësohet me Arbenën e cila ka qenë edhe më herët në komision, por tani Arbena do të i mbulojë edhe shkollat fillore dhe çerdhet ky është ndryshimi i vetëm. Anëtarët që janë nga Ministria emrat e tyre nuk duhet votohen kështu që votohen vetëm ekspertët e jashtëm dhe anëtarët e DKA-së.

**Leutrim Retkoceri** tha se mirë është që tani ky propozimvendim është i bazuar edhe në udhëzimin e fundit administrativë të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për shkak të mungesës së kësaj procedure ne e dimë përzgjedhja vitin e kaluar e drejtorëve ka përfunduar në ankesë dhe është kthyer ai vendim. Tani besoj se janë përfill të gjitha procedurat, është mirë që ka pasur një procedurë publike për rekrutimin e ekspertëve të pa varur.



**Bahri Gashi** pyeti a ka afat ky komision a është me afat apo pa afat, pasi qenka për 1 vit dhe sa drejtorë kanë me i zgjedhur ky komision brenda 1 viti.

**Besianë Musmurati** tha se për afërsisht kanë me i zgjedhur rreth 60-70% të drejtorëve.

**Gëzim Sveçla** tha se a nuk ka pas më shumë persona të kualifikuar për me qenë, gjatë kësaj kohe e këta persona që janë të caktuar në komisione a bëjnë edhe punë tjera, apo kanë me u marrë vetëm me çështjen e rekrutimit.

**Besianë Musmurati** tha se Arbena tani ka mu marrë vetëm me çështjen të rekrutimit.

**Alban Zogaj** nënkryetar e falënderoi drejtorin për të gjithë punën dhe propozimet dhe ftoj asamblistët, grupet dhe të tjerët me vëzhguar procesin, sepse e kanë të drejtën e plotë.

Procesi do të vëzhgohet edhe nga këshillat e prindërve edhe nga mediat dhe nga Shoqëria civile por edhe asamblistët është shumë me rëndësi me qenë pjesë e këtij procesi andaj dhe ju ftoj.

**Nora Kelmendi** tha se vetëm na i dërgoni oraret.

**Besianë Musmurati** tha se e kemi ftuar shoqërinë civile, e kemi ftuar GAP-in, dhe krejt grupeve kemi me ju dërguar ftesë, vetëm le të votohet komisioni.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi**

**Gëzim Sveçla** tha se është dashur që dikush nga ekzekutivi me e propozuar, mendoj së kjo propozimrregullore nuk është e hartuar ashtu si duhet, dhe mendoj se ka pasur nevojë shumë për rregulloret tjera për momentin janë shumë ma të rëndësishme.

**Leutrim Retkoceri** tha se kjo rregullore që nga viti 2010 nuk ka ndryshuar dhe nëse del në diskutim është puna ma mirë, pra sa më shumë rregullore dalin në diskutim publik, vijnë ndryshohen, përmirësohen.

**Bahri Gashi** tha se kjo rregullore nuk është për Prishtinë, konsideroj se ndoshta është më mirë me u rishikuar rregullorja brenda e pastaj me dal në diskutim publik.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me rojektregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e shtatë**

**Informatë lidhur me mbjelljet pranverore në Kryeqytet**



**Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata lidhur me mbjelljet pranverore në Kryeqytet dhe dërgohet në Kuvend.**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në lagjen "Kolovicë e Re", në Prishtinë**

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në lagjen "Mati 1" në Prishtinë**

**Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në lagjen "Kolovicë e Vjetër", në Prishtinë**

**Besianë Musmurati** dha se arsyeja pse i kemi mbledhur këto pika është se në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit po kërkojnë prona komunale që mundemi me i dërguar kur ka nevojë për çerdhe të cilat do të financohen dy nga Ministria e Arsimit dhe e treta është për BIK-un.

**Florim Krasniqi** tha se i përket caktimit të këtyre tri lokacioneve, Drejtoria e Planifikimit është bazuar në dy elemente, elementi i parë është elementi i pronësisë që është pronë komunale dhe elementi i dytë që ka dendësi dhe nevojë për çerdhe në këto tri lokacione.

Në "Kolovicë të Vjetër" në bazë të Planit Zhvillimor Urban destinimi i propozimit në PZHU është banim individual. Në arsyetim kemi propozua që destinimi me të cilin kemi propozuar me vendos çerdhen.

Po ashtu edhe në lokacioni tjetër "Kolovicë e Re", në bazë të PZHU-së, propozohet për banim individual, ndërsa në "Matin 1", me Plan rregullues në këtë rast kemi plan i cili është i aprovuar qysh në vitin 2005 e pastaj në vitin 2010-2011 që ka pasur revidim të këtij plani.

**Bahri Gashi** tha se unë mendoj se është gabim me ja ndërruar destinacionin dhe mendoj nëse ka vend me i ndërtuar dy çerdhe ose me bërë ndërrim të pronave.

**Gëzim Sveçla** tha se ku është dallimi "Kolovicë e Re" dhe "Kolovicë e Vjetër", a mundesh me na sqaruar se këtu në të dyja po shkruan vetëm Kolovicë dhe kjo shkolla fillore "Miladin Popoviq" nuk e di ku është.

**Florim Krasniqi** tha se në regjistrat katastral kështu shkruan shkolla fillore "Miladin Popoviq".

**Gëzim Sveçla** pyeti cilat kanë qenë kriteret për caktimin e këtyre tri lokacioneve.

**Florim Krasniqi** tha se janë dy faktorë, faktori i pronësisë komunale që është numër një dhe faktori numër dy është dendësia në këto lagje të cilat nuk kanë asnjë çerdhe.

**Leutrim Retkoceri** tha se çka është me rëndësi që janë gjetur këto prona, por dëshiroj që me lëviz diçka me OSHP-në, për ndryshe edhe planifikimet tjera edhe për çerdhe edhe për shkolla kanë me mbet aty.

**-Kryesuesi konstatoi se u miratuan Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në lagjen "Kolovicë e Re", në Prishtinë;**

**-Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në**



lagjen "Mati 1", në Prishtinë dhe

-Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor në lagjen "Kolovicë e Vjetër" në Prishtinë dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

**Pika e njëmbëdhjetë**

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu "KOSTT" SH A.

Lidhur më këtë propozimvendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Doruntinë Maloku**, drejtores.

**Gëzim Sveçla** tha se duke e ditur që është çështje emergjente e cila pa tjetër duhet zgjidhje, mendoj që është dashtë që sot ta kemi ndonjë material për këtë dhe neve sot po na kërkohet me dhënë një mendim tonin për diçka që nuk e dimë.

**Nora Kelmendi** tha ti duhesh me ja dhënë 144m<sup>2</sup> në shfrytëzim me nda parcelën me një numër të ri dhe vetëm ato 144m<sup>2</sup> mi dhënë në shfrytëzim.

**Alban Zogaj, nënkryetar** tha ndoshta është mirë me sqaruar praktikën e kaluar se ato shtylla kanë qenë të vendosura.

**Shkëmb Manaj** tha këtu kemi zhvendosje prej një lokacioni që ka qenë pronë komunale me një pronë komunale. Lokacioni që lirohet ku ka qenë shputa e vendosur prapë i kthehet në pronësi të Komunës zakonisht kur është në pyetje prona për shfrytëzim për shputa që vendoset tensioni i lartë zakonisht ka kaluar automatikisht në pronësi të KOSTT-it. Ne i kemi pasur këto dilema për arsyetimin a do të duhet këtë pjesë të bëhet vetëm zhvendosja, vendosja prej një prone komunale në pronë komunale a duhet vetëm pëlqim apo duhet me ardhur me procedurë të Kuvendit të Komunës.

**Leutrim Retkoceri** tha se po flas prej praktikës së kaluar ne e kemi dhënë në shfrytëzim prona komunale për trafo siç e cekët edhe ju në rastin e tillë unë ti kisha dhënë dy sugjerime.

E para e punës është nëse shputa është tu vendos nga një pronë komunale në pronë tjetër komunale duhet me qenë në marrëveshje shputa e cila demolohehet duhet të demolohehet në pronën paraprake dhe të kthehet në gjendjen çfarë do që është dhe sugjerimi tjetër është do të ishte shumë me rëndësi sepse ne e dimë edhe Planet Rregulluese në momentin që vendoset dhe ndryshohet linja e infra konstrukcionit të lartë në atë linjë më nuk lejohet ndërtimi i vendbanimeve. Sa i përket afateve në lidhje me këtë unë minimalisht kisha propozuar që duhet të jetë 30 vjet nëse për trafo e kemi dhënë 15 vjet.

**Gëzim Sveçla** tha se për Kuvend të jetë e definuar, se po flasim për 144 m<sup>2</sup> nëse e shohim këtë raportin që e kanë dërguar ata këtu paskan mu vendos dy shtylla, distanca në mes tyre është shumë e afërt gjithë ajo është e shfrytëzueshme dhe mos mendoni që mundeni me shfrytëzuar dhe do të ishte mirë që me i marrë praktikën e komunave tjera.

**Doruntinë Maloku** tha se çështja e shtyllave të tensionit të lartë është një problematik e telave të tyre është problematik që e hasim gjithë, mendoj jo vetëm Komuna e Prishtinës por gjitha komunat duhet me bërë një marrëveshje me KOSTT-in dhe me rregulluar këtë problem.

**Alban Zogaj** nënkryetar tha se kërkesë e KOSTT-it, ne duhet me i marrë me seriozitet të lartë.

**Bahri Gashi** tha se sa i përket dhënies së pronës duhet me dhënë ndërsa materialet të cilat po na vijnë në momentin e fundit kjo është bërë praktikë shumë e keqe dhe nuk jam për me e



penguar, jam për çerdhe dhe për me e vendosur shtyllën por që materialet të na dërgohen më kohë.

**Osman Billaca** tha se materialin i përgatitim dhe ju dërgojmë, çdo ndryshim ju përcjellim, materialet kanë me qenë të sigurta për seancë.

**Pika dymbëdhjetë**

**Të ndryshme**

**Nora Kelmendi** tha se mbasi këtu nuk është kryetari as nënkryetari çdo seancë na bëjmë pyetje asnjë herë asnjë përgjigje nuk na është dhënë as me shkrim as nuk ju kanë përgjigjur drejtoret shumë rrallë, kështu që pyetjet që i parashtrojmë do të ishte mirë që të kthehen përgjigjet.

**Milazim Vitija** tha se në të gjitha seancat prej që ka filluar me këtë kryetar, deri në fund ka marrë pjesë kryetari dhe ka dhënë sqarime të duhura.

**Nora Kelmendi** tha se disa nga drejtoret nuk na kanë dhënë përgjigje.

*Mbledhja përfundoi në orën 12:00.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit  
Fehmi Kupina**

